



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. 6658 Prot.

Tiranë, më 20.06.2018

URDHËR

Nr. 337, Datë 20.06.2018

PËR

EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË SPORTIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 12 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 16 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, nenit 9 të ligjit nr. 79/2017 “Për Sportin”, dhe pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 09.05.2018 “Për përcaktimin e përbërjes strukturore e të shpërbllimit të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit”,

URDHËROJ:

1. Emërimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit, si më poshtë:

- |                          |  |
|--------------------------|--|
| a. Znj. Lindita Nikolla  | Kryetar. Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.                             |
| b. Z. Konstandin Shkurti | Zv/Kryetar. Zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.                  |
| c. Z. Avni Ponari        | Anëtar. President i Federatës Shqiptare të Basketbollit.                     |
| d. Z. Armand Duka        | Anëtar. President i Federatës Shqiptare të Futbollit.                        |
| e. Z. Erli Pëllumbi      | Anëtar. President i Federatës Shqiptare të Volejbollit.                      |
| f. Z. Arben Kaçurri      | Anëtar. Drejtor i Institutit Kërkimor Shkencor të Universitetit të Sporteve. |
| g. Z. Lorik Cana         | Anëtar. Ish Futbollist i shquar i ekipit përfaqësues të Shqipërisë.          |
| h. Z. Ilir Trebicka      | Anëtar. Ish Basketbollist i shquar i ekipit përfaqësues të Shqipërisë.       |
| i. Znj. Klodeta Dibra    | Anëtar. Ish Basketbolliste e shquar e ekipit përfaqësues të Shqipërisë.      |
| j. Z. Seyhan Pencapligil | Anëtar. Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Kombëtare Tregtare                   |
| k. Z. Eneid Likaj        | Anëtar. Drejtor i Shoqërisë “Vodafone Albania”                               |
| l. Z. Rezart Saphia      | Anëtar. Jurist   |
| m. Z. Ervin Baku         | Anëtar. Gazetar Sportiv  |
| n. Z. Dritan Sallaku     | Sekretar. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.                           |

2. Këshilli i Lartë i Sportit, të marrë masa për hartimin dhe zhvillimin e politikave për sportin, si dhe organizimin e veprimtarisë së tij, sipas kërkesave dhe detyrave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në MASR dhe anëtarët e Këshillit të Lartë të Sportit.

*Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

**MINISTËR**

**Lindita NIKOLLA**

